



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. _____ /2020

Datë: 27.02.2020

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dhe në nenin 18 të Statutit të Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 27.02.2020 pas diskutimit lidhur me pikën e 4 të rendit të ditës: Propozim-Vendim për caktimin e parcelës 00775-0, Z.K. Skivjan, për ndërtimin e objektit për ushtrimin e aktiviteteve të banorëve të fshatit Skivjan, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Caktohet lokacioni për ndërtimin e objektit për ushtrimin e aktiviteteve të banorëve të fshatit Skivjan .
2. Lokacioni ku do të ndërtohet objekti për ushtrimin e aktiviteteve të banorëve të fshatit Skivjan caktohet në parcelën 00775-0, Z.K. Skivjan në sipërfaqe prej 1148m², në pronësi të Komunës së Gjakovës .
3. Qëllimi i ndërtimit të këtij objekti është ushtrimi i aktiviteteve të ndryshme të banorëve të fshatit Skivjan, që do të ju shërbejë për interes të përgjithshëm të gjithë banorëve të fshatit.
4. Ndërtimi i objektit do të bëhet me vetëfinancim të banorëve të fshatit Skivjan .
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .
6. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
 - Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë .
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
 - Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Anton Shala